



Kush planifikon një udhëtim së pari duhet ta dijë cili është qëllimi i tij dhe në cilat etapa ai mund të arrihet. Pikërisht kështu është edhe me mësim-nxënien. Ti duhet të kesh një qëllim dhe po ashtu rrugën deri te ky qëllim duhet ta ndash në etapa ose në pjesë të qëllimit, në mënyrë që të mund t’ia dalësh me sukses.

Shembull:

- Brenda dhjetë ditëve duhet ta mbash një referat për luanin. Qëllimi yt është ta mbash vërtet një referat të mirë dhe të fitosh notë të mirë. Tash këtë qëllim e ndan në etapa vijuese për ditët e ardhshme:

E hënë	Merr në bibliotekë libra për luanin dhe shikoji me kujdes. Mbaj shënime.
E martë	Kërko në internet. Hapi vegëzat (linket) e rëndësishme. Mbaj shënime.
E mërkurë	Shikoji shënimet. Bëje skicën e parë për ndërtimin e referatit.
E enjte	Puno më tej ndërtimin e skicës. Siguroji informatat e munguara.
E premte:	Shkruaje referatin si projekt/skicë.
E shtunë dhe e diel	Kërko fotografi që do të dëshiroje t’i tregojë në referat.
E hënë	Lexoje edhe disa herë tejet referatin dhe përmirësoje tekstin.
E martë	Mbaje referatin dy herë në shtëpi dhe po ashtu tregoji edhe fotografitë për të. Mate kohën.
E mërkurë	Ushtroje përmendsh 2 deri 3 herë referatin në shtëpi.
E enjte	Mbaje referatin në shkollë!

- **Te çdo punë më e madhe** shoshite se cili është **qëllimi dhe në cilat pjesë të qëllimit** apo në ç’etapa/hapa mund ta ndash rrugën deri në fund!

- Po ashtu, **çdo ditë** në fillim të kohës/orës tënde të detyrave, shoshite se cili është **qëllimi** apo cilat janë **pjesët e qëllimit** për sot.

### Këshillë

Çdo ditë, në fillim të orës së detyrave, bëje një plan pune në të cilin i shënon punët dhe qëllimet apo etapat për sot!

## Plan pune: Referati për Londrën

JAVA 1	E hënë, më 5. 3.	E martë, më 6. 3.	E mërkurë, më 7. 3.	E enjte, më 8. 3.	E premte, më 9. 3.	E shunte dhe e diel 10. 3. + 11. 3.
	Do të kërkoj libra për Londrën në bibliotekë	Kërkoj in- formata për Londrën në internet → mbaj shënime	- I rilexoj shënimet  - Bëj një skicë të parë të referatit	Vazhdoj me skicën, e konkretizoj	Kërkoj infor- mata që më mungojnë akoma	E shkruaj krejt referatin në një version të parë

JAVA 2	E hënë, më 12. 3.	E martë, më 13. 3.	E mërkurë, më 14. 3.	E enjte, më 15. 3.	E premte, më 16. 3.	
	Kërkoj foto- grafi etj. për Londrën  E rilexoj dhe e përpunoj va- riantin e parë të referatit	- E rilexoj versionin e përpunuar të referatit  - Bëj përmirë- sime  - E ushtroj referatin	- Bëj një kuiz që do ta lua- jmë në fund të referatit  - E ushtroj 2 herë referatin	E ushtroj 2-3 herë referatin; mundësisht përmendsh  Do ta mas kohën	MBAJTJA E REFERATIT NË SHKOLLË në orën 9 !!!	

### Këshillë

Te punët më të mëdha të planit tënd javor shëno, po ashtu, edhe etapat/hapat që u përkasin këtyre punëve! Shembulli sipër ta tregon si bëhet kjo

### Ushtrimi 7

Mendoje mirë se cilat detyra më të mëdha duhet t'i kryesh në dy tri javët e ardhshme. Punoje një plan me qëllimin dhe etapat/hapat (si më sipër). Nëse nuk ke ndonjë punë më të madhe në duar, atëherë shtroja vetes detyrën në vijim: Brenda dy javësh duhet ta mbash një referat për Londrën. Si do të veproje? Bëje një planifikim të hapave/etapave të veçanta!

